**Universiteti i Prizrenit “Ukshin HOTI” – Fakulteti Juridik**

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **PROGRAMI MËSIMOR – SYLLABUS** | | | | | | | |
| **Niveli i studimeve** | **Bachelor** | **Programi** | **JURIDIK** | **Viti akademik** | | **2016/17** | |
| **LËNDA** | **Mbrojtja Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut** | | | | | | |
| **Viti** I-rë / **Semestri** II-të | **Statusi i lëndës** | **obligative** | **Kodi** | | **ECTS kredi** | **7** | |
| **Javët mësimore** | 15 | Orët mësimore 45 | | | Ligjërata 3 | Ushtrime 2 | |
| **Metodologjia e mësimit** | Metodologjia e ligjërimit do të orientohet në krijimin e mundësive te studentët për të zotëruar dhe fituar njohuritë për lëndën: “*Mbrojta Ndërkombëtare e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut”*. Do të inkurajohen studentët që të marrin pjesë në mënyrë aktive në ligjërata dhe ushtrime përmes prezantimeve të ndonjë eseje ose punimi seminarik nga fusha e kësaj të drejte. Ligjërata do të prezantohet sipas metodës interaktive (sokratike). Gjatë ligjërimit të lëndës po ashtu do të përdoren metodat bashkëkohore të mësimdhënies, me efekt që kjo disiplinë e së drejtës të bëhet më e kapshme, më e qartë dhe më e lehtë për t’u mësuar dhe zbatuar. | | | | | | |
| **Konsultime** | Sipas orarit | | | | | | |
| **Mësimdhënësi** | **Prof.Ass.Dr. Halim Bajraktari** | e-mail | halim.bajraktari@uni-prizren.com | | | | |
| | | Tel. | | | | | |
| **Asistenti** | **Ass. Shefki Shtërbani** | e-mail | shefki.shterbani@uni-prizren.com | | | | |
| | | Tel. | | | | | |

| **Qëllimi studimor i lëndës** | **Përfitimet e studentit** |
|---|---|
| Lënda ka për qëllim që studentit t’i ofrojë njohuritë e nevojshme lidhur me rendin publik ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, strukurën ligjore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si dhe mekanizmat për mbrojtjen e këtyre të drejtave në përgjithësi dhe lidhur me këto të drejta në Kosovë në veçanti, njëherit duke përfshirë një analizë kritike lidhur me strukturën institucionale dhe zbatuese, që paraqesin një interes thelbësor lidhur me lëndën.<br>Qëllim i kësaj lënde është që të bëjë një analizë lidhur me shqyrtimin e dispozitave ligjore, rasteve praktike dha masat që duhen të ndërmerren lidhur me shkeljen e të drejtave të njeriut, si në sistemin vendor, rajonal po ashtu edhe në sistemin ndërkombëtar të të drejtave të njeriut. Gjithashtu do t’i kushtohet rëndësi edhe sistemit kushtetues dhe ligjor të mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Kosovë.<br>Përfundimisht, kjo lëndë ka për qëllim që të ofrojë njohuri thelbësore lidhur me të drejtat e njeriut, strukturën institucionale të sistemit nërkombëtar, | Pas përfundimit të kësaj lënde, studenti pritet të jetë në gjendje që:<br><br>Të kuptojë zhvillimin dhe diskursin e lëvizjes së të drejtave të njeriut;<br>Të definojë standartet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut;<br>Të identifikojë burimet universale dhe regjionale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut;<br>Të kuptojë dhe shpjegojë sistemet rajonale për të drejtat e njeriut, posaqërisht sistemin evropian të të drejtave të njeriut;<br>Të njoh procedurat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si në nivelin rajonal ashtu edhe në nivelin ndërkombëtar;<br>Të kuptojë dhe njohin të drejtat specifike, si p.sh. e mbrojtja e pakicave, e drejta e vetëvendosjes, ndalimi i diskriminimit, refugjatë etj;<br>Të identifikojë obligimet e shteteve lidhur me të drejtat dhe liritë e njeriut dhe të interpretojë aplikushmërinë e tyre në Kosovë,<br>Të respektojë këto të drejta duke i çmuar dhe |

| | |
|---|---|
| atij rajonal dhe sistemit vendor lidhur me mbrojtjen e të drejtave të njëriut, duke analizuar dhe studiuar raste praktike për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. | respaktuar si brenda vendit dhe në arenën ndërkombëtare,<br>Të forcojë horizontin lidhur me këtë fushë obligimesh dhe detyrime që kanë institucionet vendore dhe ato ndërkombëtare lidhur me këto të drejta. |

| **Metodologjia për realizimin e temave mësimore:** | | |
|---|---|---|
| Ligjërata, ushtrime, qasje interaktive, konsultime. | | |
| **Kushtet për realizimin e temës mësimore:** | | |
| Literatura adekuate,përdorimi i mjeteve të TI. | | |
| **Mënyra e vlerësimit të studentit ( në%)** | | |
| Provimi llogaritet i suksesshëm nëse studenti i arrinë 51% të pikëve të mundëshme (100).<br><br>Çdo student duhet t'i nënshtrohet provimit!<br><br>Pjesëmarrja dhe angazhimi në mësim do të vlerësohet me 10% të pikëve të mundshme (100). | **Vlerësimi në %** | **Nota përfundimtare** |
| | 95-100 | Njohuri të jashtëzakonshme (10) |
| | 81-95 | Shkëlqyeshëm (9) |
| | 71-80 | Shumë mirë (8) |
| | 61-70 | Mirë (7) |
| | 51-60 | Mjaftushëm (6) |
| | | |
| | | |
| | | |
| **Obligimet e studentit:** | | |
| **Ligjërata:**<br><br>Që të jetë prezent dhe në mënyrë interaktive të diskutoj për temat e shtjelluara. | **Ushtrime:**<br><br>Që të jetë prezent dhe në mënyrë interaktive të diskutoj për shembujt e shtjelluar. | |

| **Ngarkesa e studentit për lëndën** | | | |
|---|---|---|---|
| **Aktiviteti** | **Orë** | **Ditë/Javë** | **Gjithsej:** |
| Ligjërata | 3 | Mërkure-15 javë | 45 orë |
| Ushtrime | 2 | 15 | 30 |
| Punë praktike | | | |
| Kontakte me mësimdhënësin/konsultime | 0,5 | 15 javë | 7.5 orë |
| Ushtrime në terren | | | |
| Seminare | 0.5 | 15 javë | 7.5 |
| Detyra të shtëpisë | | | |
| Koha e studimit vetanak | 3 | 15 javë | 30 |
| Përgatitja përfundimtare për provim | 3 | 15 Javë | 30 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuize, provim final) | | | |
| Projekte,prezantime..etj | | | 5 |
| **Vërejtje: 1 ECTS kredi=25 orë angazhim,p.sh nëse lënda i ka 6 ECTS kredi student duhet të ketë angazhim gjatë semestrit 150 orë** | | **Ngarkesa totale:** | **175** |

| Java | Ligjërata | | Ligjërata | |
|---|---|---|---|---|
| 1. | **Tema** | **L Orët** | **Tema** | **U Orët** |
| | Njohje e përgjithshme me metodologjinë e punës, hyrje në të drejtën ndërkombëtare të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut, origjina dhe kuptimi i të drejtave të njeriut, nocionet. | 3 | Prezentimi akademik e metodologjik. | 2 |
| | | | | |
| 2. | Zhvillimi historik, paraqitja e të drejtave të njeriut.<br>Burimet e së Drejtës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut. | 3 | Pyetje për diskutim<br><br>*Zejnullah Gruda*, 3-11<br><br>*Zyberi& Qerimi, fq. 66-91* | 2 |
| | | | | |
| 3. | Nocioni të drejtat dhe liritë e njeriut, sistemi universal i mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut, Karta e OKB-së dhe të drejtat e njeriut, mekanizmat dhe organet e OKB-së për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut. | 3 | Pyetje për diskutim, interaktivitet<br><br>*Zejnullah Gruda, 13-28* | 2 |
| | | | | |
| 4. | Këshilli i Asamblesë të OKB-së për të drejtat e njeriut. Deklarata Univerzale për të drejtat e njeriut, Paktet mbi të drejtat e njeriut, mekanizmat për implementimin e pakteve. | 3 | Pyetje për diskutim, interaktivitet, shembuj<br><br>*Zejnullah Gruda, 28-43* | 2 |
| | | | | |
| 5. | Sistemi Europian për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, Këshilli i Europës, Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut. | 3 | Pyetje për diskutim, interaktivitet, shembuj<br><br>*Zejnullah Gruda, 47-75* | 2 |
| | | | | |
| 6. | Gjykata Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut; Juridiksioni dhe mjetet juridike.<br>Procedura para Gjykatës. | 3 | Pyetje për diskutim, interaktivitet, shembuj<br><br>*Zejnullah Gruda*, 47-75 | 2 |
| | | | | |
| 7. | Sistemet tjera (Organizatat egjionale si: OUA, LA, OSHA) për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. | 3 | Pyetje për diskutim, interaktivitet, shembuj<br><br>*Zejnullah Gruda, 77-96* | 2 |
| | | | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 8. | **Kollokfium/Test/Ushtrim/Casus** | 3 | | 2 |
| 9. | -E Drejta e Popujve për Vetëvendosje.<br>-Roli i OJQ-ve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, OJQ-të në Kosovë. | 3 | *Zejnullah Gruda,fq. 151-172*<br><br>*Zyberi& Qerimi, fq. 196-213*Pyetje për diskutim, interaktivitet | 2 |
| 10. | -Parimi i ndalimit të diskriminimit, normat dhe mekanizmat ndërkombëtare për ndalimin e diskriminimit, institucionet ndërkombëtare të specializuara për luftimin e diskriminizmit.<br>-Aparteidi. | 3 | Pyetje për diskutim<br><br>*Zejnullah Gruda, fq. 175-194* | 2 |
| 11. | Mbrojtja e të drejtave të njeriut në konflikte të armatosura, Konventat e Gjenevës. | 3 | Pyetje për diskutim, interaktivitet, shembuj<br><br>*Zyberi& Qerimi, fq. 263-285* | 2 |
| 12. | Gjenocidi, historiku i tij, Konventa mbi parandalimin e gjenocidit, përgjegjësitë ndërkombëtare penalo-juridike, Gjykata e Përhershme Penale Ndërkombëtare. | 3 | Interaktivitet<br><br>*Zejnullah Gruda, fq.245-256* | 2 |
| 13. | -Mbrojtja ndërkombëtare e refugjatëve dhe e drejta e azilit, aktet ndërkombëtare mbi trajtimin e refugjatëve, masat humanitare për refugjatë, llojet e azilit.<br>-Mbrojtja e pakicave nacionale. | 3 | Pyetje për diskutim, interaktivitet, shembuj<br><br>*Zejnullah Gruda, fq. 211-242* | 2 |
| 14. | Mbrojtja e të drejtave të njeriut në Kosovë, hirarkia normative, aplikushmëria e drejtpërdrejtë e normave ndërkombëtare në Kosovë, mbrojtja e pakicave nacionale. | 3 | Pyetje për diskutim<br><br>*Zyberi& Qerimi, fq. 170-196* | 2 |
| 15. | *Debate rreth lëndës, diskutime, praktikim, këshilla dhe rekomandime, debate për përgaditjen e provimit përfundimtar.* | 3 | Përgaditja për provim... | 2 |

| **LITERATURA** |
|---|
| ***Literatura themelore:*** <br><br> 1. ***E Drejta Ndërkomëtare e të Drejtave të Njëriut,*** **Gentian ZYBERI dhe Qerim QERIMI, botimi i dytë, Shkurt, 2015.** <br> 2. ***Mbrojtja Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut,*** **Zejnullah Gruda, Botim i pestë, Prishtinë 2010.** <br><br> ***Tekstet e Rekomanduara:*** <br> - *"Hyrje në Mbrojtjen Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut" Raija Hanski,* (Insituti për të Drejtat e Njëriut, Universiteti i Abo Akademisë 1999. <br> - Walter Kalin & Jorg Kunzli, *The Law of International Humanitarian Rights Protection*, Oxford, 2009. <br> - *Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut,* Ledi Binaku, Qendra Evropiane, Kishilli i Evropës & Këshilli Evropian, Tiranë, 2005. <br> -*Internacional Protection of Human Rights: Achievements and Challenges*, Felipe Gomez Isa & Koen de Feyter, 2006 Bilbao, në internet: <br> http://www.humanitariannet.deusto.es/publica/PUBLICACIONES_PDF/International%20protect.pdf <br> -Internationaler Menschenrechtsschutz, Theodor Schilling, 2. Auflage,Tübingen 2004, në internet: <br> http://books.google.de/books?id=CEvLRfyVNc4C&printsec=frontcover&hl=de&source=gbs_ge_summary_r&cad=0#v=onepage&q&f=false |
| **VËREJTJE** |
| Studentët inkurajohen që sipas mundësive të përdorin edhe literaturë tjetër nga interneti. |

| **Vërejtje për studentin:** |
|---|
| *Studentët duhet të respektojnë rregullat e etikës profesionale akademike si: mbajtia e qetësisë në mësim, shkyçja e telefonave celular, hyrja në sallë me kohë etj. Çdo kundërvajtie lidhur me këto rregulla do të sanksionohet rreptësisht. Plagjiatura dhe fenomenet e ngjashme mashtruese do të ndëshkohen sipas rregullave në fuqi. Studenti duhet të jetë interaktiv në ushtrime dhe të reflektoj gatishmëri dhe dije për iniciativa, ide dhe demonstrim të njohurive të marra në ligjërata dhe të shfrytëzoj të gjitha mundësitë për nxënie të dijes.* <br> <u>*Komunikimi*</u> *me studentët do të bëhet kryesisht përmes e-mailit dhe shpalljeve në lokalet e Universitetit si dhe personalisht gjatë orarit zyrtar të konsultimeve.* <br><br> *Suksese.* *Prizren, 2016-17.* |